

20160531357

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBIKËQYRJE INSPEKTUESE

Neni 1

Në Ligjin për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 50/10, 162/10, 157/11, 147/13, 41/14, 33/15 dhe 193/15), në nenin 16 paragrafi (11) në alinenë 2 numri "300" zëvendësohet me numrin "240".

Në paragrafin (13) në alinenë 2, numri "300" zëvendësohet me numrin "240".

Neni 2

Në nenin 16-a në paragrafin (5) pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët "përveç në Ministrinë e Mbrojtjes."

Neni 3

Në nenin 19-a paragrafi (1) alineja 6 ndryshohet si vijon:

"-i ndërpritet punësimi, për shkak të moshës në pajtim me rregullat nga sfera e marrëdhënieve të punës,"

Neni 4

Në nenet 22-a paragrafi (2) alineja 1 dhe 22-b paragrafi (2) alineja 1 numri "300" zëvendësohet me numrin "240".

Neni 5

Në nenin 24 pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3) si vijojnë:

"(2) Inspektori i cili e udhëheq procedurën inspektuese, mund që sipas detyrës zyrtare t'i kërkojë dëshmitë dhe të dhënat për të cilat evidencë zyrtare udhëheq organi publik kompetent.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent nga i cili janë kërkuar të dhënat e kërkuara nga paragrafi (2) i këtij neni është i detyruar që t'i dorëzojë dëshmitë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës."

Paragrafët (2), (3) dhe (4) bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6).

Neni 6

Nenet 40 dhe 41 shlyhen.

Neni 7

Në nenin 42 pas paragrafit (5) shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

"(6) Formën dhe përmbajtjen e aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni i përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës."

Neni 8

Inspektorët të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune para ditës së fillimit të zbatimit të nenit 18 paragrafi (1) i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 147/13), e nuk e përmbushin kushtin të kenë së paku pesë vjet stazh pune në sferën përkatëse të shërbimit inspektues pas diplomimit, mund të marrin licencë të përkohshme për inspektor pa dhënie të provimit për inspektor, me të cilin mund të kryejnë mbikëqyrje inspektuese, ndërsa duhet të marrin licencë në afat prej një viti nga përmbushja e këtij kushti.

Pas mbarimit të vlerësimit të inspektorëve për vitin 2015, nuk do të miratohet aktvendim për realizimin e masave në pajtim me nenin 19-a, paragrafi (9) nga Ligji për mbikëqyrje inspektuese ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 50/10, 162/10, 157/11, 147/13, 41/14, 33/15 dhe 193/15)

Neni 9

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin sipas të cilit kanë filluar.

Neni 10

Dispozitat e neneve 5, 6 dhe 7 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".